

VENDIM
Nr. 42, datë 11.9.2012

PËR SHQYRTIMIN E AKTIT NORMATIV NR. 4, DATË 14.12.2011 “PËR NJË NDRYSHIM ME LIGJIN NR. 10 355, DATË 2.12.2011 “PËR BUXHETIN E VITIT 2011”, TË NDRYSHUAR”

Komisioni i Ndihmës Shtetërore i përbërë nga z. Edmond Haxhinasto, kryetar, z. Zef Preçi, nënkryetar dhe znj. Mimoza Dhëmbi, z. Dritan Hylli, anëtar, mori në shqyrtim aktin normativ nr. 4, datë 14.12.2011 “Për një ndryshim në ligjin nr. 10 255, datë 2.12.2011 “Për buxhetin e vitit 2011”, të ndryshuar”.

Objekti: Vlerësimi i ekzistencës së ndihmës shtetërore në aktin normativ nr. 4, datë 14.12.2011 “Për një ndryshim në ligjin nr. 10 355, datë 2.12.2011 “Për buxhetin e vitit 2011”, të ndryshuar.

Baza ligjore: Ligji nr. 9374, datë 21.4.2005 “Për ndihmën shtetërore”, të ndryshuar, si dhe vendimi i Këshillit të Ministrave, nr. 817, datë 28.12.2005 “Për miratimin e rregullores “Për procedurat dhe formën e njoftimit”, Komisioni i Ndihmës Shtetërore, pasi shqyrtoi raportin e përgatitur nga Drejtoria e Tregut të Brendshëm, në Ministrinë Ekonomisë Tregtisë dhe Energjetikës dhe gjithë dokumentacionin mbështetës,

VËREN SE:

1. Masa synon lëshimin e letërgarancisë së qeverisë në favor të ndërmarrjes KESH sh.a., me qëllim lehtësimin e likuiditeteve të nevojshme për të bërë pagesën e faturave të importit të energjisë. Mbështetja buxhetore i jepet KESH sh.a., në një shumë prej 4.5 miliardë lekësh, në mënyrë që të marrë kredi nga bankat me kosto sa më të ulëta, për të përballuar nevojën që ka për import të energjisë elektrike.

2. Masa nuk ka efektet në deformimin e konkurrencës, duke qenë se furnizuesi publik me shumicë, pjesë e KESH sh.a., është i vetmi subjekt i licencuar në vend, i cili ka detyrimin të blejë energji elektrike nga gjenerimi publik, prodhuesit e pavarur të energjisë elektrike apo prodhuesit e vegjël të energjisë elektrike dhe tregtuesit, për nevojat e klientëve tariforë siç është përcaktuar në nenin 3 pika 30/2 të ligjit nr. 9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, pikës 4.7 të modelit të tregut të energjisë elektrike të miratuar me vendim të Këshillit të Ministrave nr. 338, datë 19.3.2008, të ndryshuar, si dhe vendimin e Bordit të Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë, nr. 11, datë 23.6.2006, të ndryshuar, lidhur me licencimin e shoqërisë KESH sh.a., për aktivitetin e furnizuesit publik me shumicë të energjisë elektrike.

Furnizuesi publik me shumicë të sigurojë të gjitha furnizimet e disponueshme, përfshirë importet, për të shmangur kufizimin e ngarkesës duke blerë energji elektrike nga PVE-të¹ dhe PPE-të² me çmim të rregulluar, të miratuar nga Enti Rregullator i Energjisë dhe po me çmim të rregulluar, të miratuar nga ky ent, ia shet energjinë elektrike “CEZ Shpërndarje” sh.a./furnizuesit publik me pakicë, për furnizimin e konsumatorëve tariforë.

3. Akti normativ nr. 4, datë 14.12.2011 “Për një ndryshim në ligjin nr. 10 355, datë 2.12.2011 “Për buxhetin e vitit 2011”, të ndryshuar nuk konsiderohet ndihmë shtetërore, siç është parashikuar në nenin 4 të ligjit nr. 9374, datë 21.4.2005 “Për ndihmën shtetërore”, të ndryshuar.

PËR KËTO ARSYE,

Komisioni i Ndihmës Shtetërore, në bazë të nenit 4, 17, 29, 30 dhe 31 të ligjit nr. 9374, datë 21.4.2005 “Për ndihmën shtetërore”, të ndryshuar,

VENDOSI:

¹ “PVE”- prodhuesi u vogël i energjisë elektrike i lidhur në sistemin e shpërndarjes së energjisë elektrike.

² “PPE”- prodhues i pavarur i energjisë elektrike i lidhur në sistemin e transmetimit të energjisë elektrike.

1. Akti normativ nr. 4, datë 14.12.2011 “Për një ndryshim në ligjin nr. 10 355, datë 2.12.2011 “Për buxhetin e vitit 2011”, të ndryshuar”, nuk përbën ndihmë shtetërore, sipas përcaktimit të nenit 4 të ligjit nr. 9274, datë 21.4.2005 “Për ndihmën shtetërore”, të ndryshuar.

2. Me këtë vendim të njoftohet Ministria e Financave.

3. Ky vendim të botohet në Fletoren Zyrtare.

4. Kundër vendimit të mësipërm mund të bëhet ankimi në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, brenda 30 ditëve nga marrja në dijeni. Ankimimi ndaj vendimit të mësipërm nuk pezullon ekzekutimin e këtij vendimi.

KRYETARI
Edmond Haxhinasto